

**V E N D I M**  
PER REGJISTRIM SI PERSON JURIDIK

Në Tiranë sot më datë . . . . . 1998 unë gjyqetarja e rrethit Tiranë. . . . . pasi u njoha me materialet e paraqitura nga  
**KERKUESIT:**

**Meriman PALUSHI** i biri i Ahmetit, i datëlindjes 1959, lindur dhe banues në Kukes, L.5, shk.5 ap.5, i identifikuar me pasaportën EV 039806

**Qamil ADEMAJ** i biri i Milaimit, i datëlindjes 1953, lindur dhe banues në Kukes, i identifikuar me letërnjoftimin Nr EV 025887,

**K O N S T A T O V A :**

Se kërkesa për regjistrimin si person juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "**A.P. LUMA-1**" SH.P.K. **KUKES**, me ortakët z. **Meriman PALUSHI** dhe z. **Qamil ADEMAJ**, kapital themeltar 100.000 (njëqindmijë) lekë, kohëzgjatje mbi 20 vjetë, seli në **Kukes me adresë L.5 shk.5 ap.5**, administrator të shoqërisë z. **Meriman PALUSHI** për të zhvilluar aktivitetet privat me objekt të veprimtarisë së saj: \* **veprimtarine në fushën e ndërtimit**

*Per zbatim :* ( sipas licenses perkatese te Drejtuesit Teknik z. **Qamil Milaim Ademi** Z.2067 nr.866 date 07.08.1997) **Kat 1 Punime dheu, sistemime taracime terrenesh , etj**

**Kat 3 Ndertime civile dhe ekonomike.**

**Kat 4/a Ndertim rruge kat. V, IV**

**Kat 6/a Ndertim vepra arti te vogla deri 6m**

**Kat 8/b ndertim ujsjellsash e kanalizime**

**c ndertim vepra kullimi, ujitje toke e impiante vaditese.**

**Kat10/a rikonstruksion godinash civile e ekonomike, veshje fasadash, etj**

*Per projektim :* ( sipas licenses perkatese te Drejtuesit Teknik z. **Qamil Milaim Ademi** A.0142 nr.866 date 07.08.1997) **Kat 1/c plane regulluese fshatrash e qendrash te banuara.**

**/d studime pjesore urbanistike**

**/e plan vendosje objektesh te veçanta**

**Kat 2/a projektme ndertimesh civile, ushqimore, industriale, materiale ndertimi turistike, bujqesore, etj. deri dy kate.**

**/b projektme ndertimesh civile, ushqimore, industriale, materiale ndertimi turistike, bujqesore, etj. mbi dy kate.**

**Import eksport te prodhimeve me konsruksione metalike, b/arme, plastike, druri dhe kombinime te ndryshme.**

**tregtim me shumice dhe pakice te blloqeve te betonit dhe materialeve te ndertimit si dhe prodhim dhe transportim te tyre.**

**Bar - Restorant.**

**tregtim te artikuljve te ndryshem te konsumit te gjere, ushqimore, industriale, materiale ndertimi elektroshtepiake, hidrosanitar, shkollor, lende te pare per to me shumice dhe pakice import eksport te tyre.**

**Si dhe cdo veprimtari tjeter qe vecas ose se bashku me ato te permendura me siper do te konsiderohen si te pershtatshme dhe me leverdi per rritjen dhe zhvillimin e shoqerise.**

Meqenese kërkesa e bërë dhe dokumentat e paraqitura i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore për t'u regjistruar si person juridik

## PER KETO ARESYE :

Në bazë të ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" si dhe në bazë të Nenit 33 të ligjit nr. 7667 datë 28.01.1993 "Për Rregjistrimin në Rregjistrin Tregtar"

## V E N D O S A :

Të bëjë regjistrimin si person juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "A.P. LUMA-1" SH.P.K. KUKES, me ortakët z. Meriman PALUSHI dhe z. Qamil ADEMAJ, kapital themeltar 100.000 (njëqindmijë) lekë, kohëzgjatje mbi 20 vjetë, seli në Kukes me adresë L.5 shk.5 ap.5. administrator të shoqërisë z. Meriman PALUSHI për të zhvilluar aktivitet privat me objekt të veprimtarisë së saj:

\* veprimtarine ne fushen e ndertimit

Per zbatim : ( sipas licenses perkatese te Drejtuesit Teknik z. Qamil Milaim Ademi Z.2067 nr.866 date 07.08.1997) Kat 1 Punime dheu, sistemime taracime terrenesh , etj

Kat 3 Ndertime civile dhe ekonomike.

Kat 4/a Ndertim rruge kat. V, IV

Kat 6/a Ndertim vepra arti te vogla deri 6m

Kat 8/b ndertim ujsjellsash e kanalizime

c ndertim vepra kullimi, ujitje toke e impiante vaditese.

Kat10/a rikonstrukcion godinash civile e ekonomike, veshje fasadash, etj

Per projektim : ( sipas licenses perkatese te Drejtuesit Teknik z. Qamil Milaim Ademi A.0142 nr.866 date 07.08.1997) Kat 1/ c plane regulluese fshatrash e qendrash te banuara.

/d studime pjesore urbanistike

/e plan vendosje objektesh te veçanta

Kat 2/a projektme ndertimesh civile, ushqimore, industriale, materiale ndertimi turistike, bujqesore, etj. deri dy kate.

/b projektme ndertimesh civile, ushqimore, industriale, materiale ndertimi turistike, bujqesore, etj. mbi dy kate.

Import eksport te prodhimeve me konsruksione metalike, b/arme, plastike, druri dhe kombinime te ndryshme.

tregtim me shumice dhe pakice te blloqeve te betonit dhe materialeve te ndertimit si dhe prodhim dhe transportim te tyre.

Bar - Restorant.

tregtim te artikujve te ndryshem te konsumit te gjere, ushqimore, industriale, materiale ndertimi elektroshtepiake, hidrosanitar, shkollor, lende te pare per to me shumice dhe pakice import eksport te tyre.

Si dhe cdo veprimtari tjeter qe vecas ose se bashku me ato te permendura me siper do te konsiderohen si te pershtatshme dhe me leverdi per rritjen dhe zhvillimin e shoqerise.

Shpenzimet gjygesore u ngarkohen kerkuesve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim .

Tiranë, më

1998

GJYQTARE

*Amila Capa*

*Q*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT Tirane

NR ...19038/1...Vendimit

5082

**V E N D I M**  
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 08.04.1998 une gjyqetarja  
*Arula Cops* e rrethit Tirane pasi u njoha me materialet e paraqitura  
nga

KERKUESI:

"A.P. LUMA -1" SH.P.K.KUKES Perfaqesuar nga Administratori i saj  
z. *Meriman Palushi*, lindur dhe banues ne Kukës, i datelindjes 1959, me  
pasaporten Nr.EV 039806

**K O N S T A T O V A :**

Se me Vendimin Nr. 19038 date 16.03.1998 te Gjykates se Rrethit  
Tirane eshte vendosur rregjistrimi i "A.P. LUMA -1"sh.p.k.

Gjithashtu me *Vendimin Nr.1 te Asamblese se Ortakeve* te shoqerise  
me pergjegjesi te kufizuar "A.P. LUMA -1"sh.p.k date 1.04.1998 eshte vendosur  
te shtohet objekti i shoqerise si me poshte

Veprimtari ne fushen e e ndertimit si me poshte:

Kat.4/b ndertim rruge kat.III,II,I.

Kat.4/c Veshje me asfalto beton te rrugeve, (ndertim mbi shtrese) si dhe  
sistemim dhe asfaltim sheshe.

Meqenese kerkesa e bere dhe dokumentat e paraqitura i plotesojne te gjitha  
kushtet ligjore .

**PER KETO ARESYE :**

Ne baze te ligjit nr.7638 dt 19.II.1992 "*Per Shoqerite Tregtare*" si dhe ne baze  
te Nenit 12 te ligjit nr. 7657 date 28.01.1993 "*Per Rregjistrimin ne Rregjistrin  
Tregtar*"

**V E N D O S A :**

Te urdheroj zyren e Regjistrimit Tregtare per te depozituar *Vendimin Nr.1 te Asamblese se Ortakeve* te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "A.P. LUMA - 1 "sh.p.k. date **1.04.1998**, duke bere :

*shtesen*

veprimtari ne fushen e ndertimit si me poshte:

Kat.4/b ndertim rruge kat.III,II,I.

Kat.4/c Veshje me asfalto beton te rrugeve, (ndertim mbi shtrese) si dhe sistemim dhe asfaltim sheshe.

ne objektin e veprimtarise se shoqerise "A.P. LUMA - 1 "sh.p.k.

te ndahen regjistrimet nga njeri- tjetri me vije te kuqe dhe te behen shenimet perkatese ne kollonen .....<sup>a</sup>..... reshtin .....<sup>c</sup>.....

**Tirane, me 08.04.1998**

**GJYQTARE**

*Denise Cops*



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT TIRANE  
NR 19038/2 VENDIMI

6147

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot ne date 26.01. 1999, une gjyqtarja Smile Cafa e Gjykates se rrethit Tirane, pasi u njoha me materialet e paraqitura nga **KERKUES Meriman Palushi dhe Qamil Ademaj**

K O N S T A T O V A

Se me vendimin e gjykates se rrethit Tirane Nr 19038 date 16.03.1998 eshte regjistruar si person juridik shoqeria "A.P.LUMA" sh.p.k. dhe me vendimin Nr 2 date 19.01.1999 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise eshte vendosur largimi i ortakut Z.Qamil Ademaj, i cili pjesen e tij te kapitalit dhe te kuotave qe ka ne kete shoqeri ia dhuron Z.Meriman Palushi

Nga aktet e paraqitura nga kerkuesit ne Gjykatën e rrethit ne kete rast rezulton se dokumentacioni eshte i plote dhe ne perputhje me ligjin Nr 7638 date 19.11.1992 dhe si e tille kerkesa duhet pranuar

PER KETO ARSYE

Ne baze te nenit 23 e 24 te ligjit Nr 7667 date 28.01.1993

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimim e vendimit Nr 2 date 19.01.1999, te asamblese se ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "A.P.LUMA" per largimin e ortakut Qamil Ademaj dhe shoqeria mbetet shoqeri me nje ortak Z.Mariman Palushi i cili merr te gjithë atributet e ortakut te vetem dhe te administratorit te shoqerise.

Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe dhe te behen shenimet perkatese ne kollonen 4e5 rreshti c.

Tirane 26.01.1998

G J Y Q T A R E

*Smile Cafa*  
*Cy*  
*DF*

V E N D I M  
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane, sot me daten 15.01.2003, une Gjyqtarja e Shkalles se pare Tirane  
Anite Cep mora ne shqyrtim kerkesen per depozitim ne regjistrin tregetar te  
ndryshimeve ne shoqerine tregetare " PALUSHI "SHPK dhe Vendimin nr.3  
date 15.01.2003 te Ortakut te Vetem dhe:

KONSTATOVA

Se me vendim nr. 19038 date 16.03.1998 eshte regjistruar si person juridik,  
Shoqeria "A . P. LUMA 1" SHPK, me seli ne Kukes , me adrese L.5, Shk.5, ap 5, me  
ortake Meriman Palushi dhe Qamil Ademaj, me kapital themeltar 100.000 lek, dhe  
administrator Meriman Palushi , me objekt veprimtarie ne fushen e ndertimit dhe te  
Tregetise me afat mbi 20 vjet.

Me Vendim nr.19038/1 (5072), date 08.04.1998 te Gjyqtarit te Vetem, eshte  
vendosur depozitimi i Vendimit nr.1 me date 1.4.1998 te Asamblese se Ortakeve  
per shtimin e objektit te veprimtarise se shoqerise edhe per ndertime kat 4/b ndertim  
ruge kat III, II, I si dhe sistemim dhe asfaltim sheshe.

Me Vendim nr. 19038/2 (6147) date 26.01.1999 te Gjyqtarise te Vetem eshte  
vendosur depozitimi i Vendimit nr.2, date 19.01.1999 te Asamblese se Ortakeve te  
Shoqerise , per largimin e ortakut Qamil Ademaj dhe dhurimin e pjeses se kuotave  
te kapitalit te tij , ortakut tjeter Meriman Palushi , i cili mer te gjitha atributet e ortakut  
te vetem dhe te administratorit te shoqerise.

Me vendim nr.4 date 15.01.2003 te Ortakut te vetem eshte vendosur:

1- Transferimi i selise se shoqerise nga qyteti i Kukesit ne qytetin e Tiranes ,  
me adrese rruga "Xhorxhi Martini " Nr. 8.

2 - Ndryshimi i emertimit te shoqerise nga emertimi "A. P. LUMA 1 "SHPK, ne  
emertimin e ri " PALUSHI "SHPK.

3 - Te behen ndryshimet perkatese ne Aktin e Themelimit te Shoqerise e ne  
Statut.

4 - Ngarkohet administratori Meriman Palushi te kryeje veprimet per depozi-  
timin e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregetar.

Ne keto kushte kerkojme depozitimn e ketyre ndryshimeve ne regjistrin  
tregetar.

PER KETO ARSYE

Duke u bazuar ne ligjin nr.7667 date 28.1.1993 per regjistrin tregetar dhe Li-  
gjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare",

V E N D O S A

-Pranimin e kerkeses .

-Depozitimn prane regjistrin tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane , te  
Vendimit nr. 3 date 15.01.2003 te Ortakut te Vetem te Shoqerise "PALUSHI"SHPK.

-Shenimet ne fleten perkatese ne kolonen 4 dhe 5 .

-Regjistrimet te behen me nr. rendor ..... duke u ndare nga njeri tjetri me  
vije te kuqe.

GJYQTARE  
Anite Cep

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE**  
**NR 19038/09 VENDIMIT**

**V E N D I M**  
**I GJYQTARIT TE VETEM**

Sot me date 06 09.2005 unë gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane **Blerina Muca** pasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga administratori e shoqerise "PALUSHI" SH.P.K sh.p.k z. **Meriman Palushi** per depozitimin ne Zyren e Regjistrimit Tregtar te dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar, "PALUSHI" SH.P.K

**K O N S T A T O V A:**

Se shoqeria "PALUSHI" SH.P.K eshte rregjistruar person juridik me vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane nr 19038 date 16.03.1998, me emertimin "A.P.LUMA". Bazuar ne ligjin 7638 date 19.11.1992, "Per Shoqerite Tregtare", ortaku i vetem i shoqerise me vendimin date 02.09.2005 ka vendosur:

Shtimin e objektit te veprimtrise se shoqerise si me poshte:

Aktivitet shfrytezim, perpunim, dhe tregetim import eksport te mineraleve grupi 1-2-3-4 sipas listes bashkangjitur ligjit minerar te Shqiperise nr 7796 dt 17.02.1994 si dhe ruajtjen dhe administrimin dhe perdorimin e lendeve eksplozive e shperthyese.

Me kerkesen drejtuar Gjykates kerkuesi ka kerkuar pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne aktet e shoqerise duke depozituar vendimin e ortakut te vetem dt 02.09.2005 prane Zyres se Rregjistrimit tregtar.

Persa me sipër ne materialet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARESYE:**

Ne baze te ligjit dhe ligjit nr.7667 date 28.1.1993 "Per Regjistrimin Tregtar" dhe 7638 date 19.11.1992 „Per Shoqerite Tregtare „

**V E N D O S A.:**

- Pranimin e kerkeses,
  - Depozitimin ne zyren e Regjistrimit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te vendimit date 02.09.2005 te ortakut te vetem shoqerise "PALUSHI" SH.P.K
  - Te urdherohet Zyra e Regjistrimit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te beje ndryshimet ne kolonen .....germa .....ne regjistrimin tregtar.
  - Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.
- Kunder ketij vendimi lejohet ankimi sipas ligjit

**GJYQTARE**  
**Blerina Muca**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE**  
**NR 19038/4 VENDIMIT**

**VENDIM**  
**I GJYQTARIT TE VETEM**



Sot me date 06 09.2005 unë gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane **Blerina Muca** pasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga administratori e shoqerise "PALUSHI" SH.P.K sh.p.k z. **Meriman Palushi** per depozitim ne Zyren e Regjistrimit Tregtar te dokumentave te paraqitura ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar, "PALUSHI" SH.P.K

**KONSTATOVA:**

Se shoqeria "PALUSHI" SH.P.K eshte regjistruar person juridik me vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane nr 19038 date 16.03.1998, me emertimin "A.P.LUMA". Bazuar ne ligjin 7638 date 19.11.1992, "Per Shoqerite Tregtare", ortaku i vetem i shoqerise me vendimin date 02.09.2005 ka vendosur: Shtimin e objektit te veprimtrise se shoqerise si me poshte:  
Aktivitet shfrytezim, perpunim, dhe tregetim import eksport te mineraleve grupi 1-2-3-4 sipas listes bashkangjitur ligjit minerar te Shqiperise nr 7796 dt 17.02.1994 si dhe ruajtjen dhe administrimin dhe perdorimin e lendeve eksplozive e shperthyese.  
Me kerkesen drejtuar Gjykates kerkuesi ka kerkuar pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne aktet e shoqerise duke depozituar vendimin e ortakut te vetem dt 02.09.2005 prane Zyres se Regjistrimit tregtar.  
Persa me siper ne materialet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARESYE:**

Ne baze te ligjit dhe ligjit nr.7667 date 28.1.1993 "Per Regjistrimin Tregtar" dhe 7638 date 19.11.1992 „Per Shoqerite Tregtare „

**VENDOSA:**

- Pranimin e kerkeses,
  - Depozitim ne zyren e Regjistrimit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te vendimit date 02.09.2005 te ortakut te vetem shoqerise "PALUSHI" SH.P.K
  - Te urdherohet Zyra e Regjistrimit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te beje ndryshimet ne kolonen .....germa .....ne regjistrimin tregtar.
  - Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.
- Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit





**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE**

Nr. 19038/5 Vendimi

**V E N D I M**  
**I G J Y Q T A R I T T E V E T E M**

Sot me date    /06/2006, une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, A. Serabajani: Caco mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit Meriman Palushi, me cilesine e administratorit te shoqerise "PALUSHI" sh.p.k:

**K O N S T A T O V A**

Me vendimin Nr.19038 date 16.03.1998 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte regjistruar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "PALUSHI" sh.p.k me ortake Meriman Palushi dhe Qamil Ademaj me kapital fillestar 100.000 leke me 50% pjese takuese ne kapital. Me vendimn Nr.19038/2 date 26.01.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte vendosur shitja e kuotave te ortakut Qamil Ademaj tek ortakun Meriman Palushi, duke bere qe shoqeria te kete ortak te vetem dhe administrator Meriman Palushin.

Me vendimin Nr.5 date 01.06.2006, ortakun i vetem dhe administratorin i shoqerise ka vendosur:

1. Zmadhimin e kapitalit te shoqerise "PALUSHI" sh.p.k sipas bilancit te dates 31.12.2005.
2. Caktimin e ekspertit kontabel, zj.Adriana Kalaja, per te pergatitur raportin dhe modalitetet e zmadhimit te kapitalit te shoqerise.
3. Depozitimimin e ketij vendimi prane Zyres se Regjistrimit Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

**P E R K E T O A R S Y E**

Ne baze te ligjit Nr. 7638 dt. 19.11.1992 dhe ligjit Nr. 7661 dt. 19.01.1993 "Per Regjistrimin Tregtar"

**V E N D O S A**

- Pranimin e kerkeses.

- Depozitimin e vendimit Nr.5 dt. 01.06.2006 te ortakut te vetem te shoqerise " **PALUSHI** " sh.p.k . ne te cilen eshte vendosur:

1. Zmadhimin e kapitalit te shoqerise "**PALUSHI**" sh.p.k sipas bilancit te dates 31.12.2005.
2. Caktimin e ekspertit kontabel, zj.Adriana Kalaja, per te pergatitur raportin dhe modalitetet e zmadhimit te kapitalit te shoqerise.
3. Depozitimin e ketij vendimi prane Zyres se Regjistrimit Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane

- Te behen ndryshimet perkatese ne Zyren e Regjistrimit Tregtar.

- Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe, dhe te behen ndryshimet perkatese ne kollonat 4 dhe 5.

Kunder ketij vendimi lejohet ankimi sipas ligjit.

**GJYQTARE**

Adriana Jusoroki (caos)



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR TIRANE  
Nr. 19038 / 16 VENDIMI

**VENDIM**  
**IGJYOTARES SE VETME**

Sot me date 3072006, Une gjyqtare A.Gunbardhi (Caco) e Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e zj.Meriman Palushi per depozitim ne Zyren e Rregjistrimit Tregtar te vendimit Nr.6 date 03.07.2006 te ortakut te vetem te shoqerise "PALUSHI" sh.p.k:

**KONSTATOVA**

Shoqeria "PALUSHI" sh.p.k eshte regjistruar si person juridik me vendimin Nr.19038 date 16.03.1998, te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, me kapital themeltar 100.000 leke. Me vendimin Nr.5 date 01.06.2006 Ortaku i Vetem i shoqerise ka vendosur zmadhimin e kapitalit te shoqerise si dhe caktimin e ekspertit kontabel per pergatitjen e raportit dhe modalitetet e zmadhimit te kapitalit.

Me vendimin Nr.6 date 03.07.2006 Ortaku i Vetem, ka vendosur:

1. Miratimin e raportit te ekspertimit ne lidhje me shtesen e kapitalit te shoqerise "PALUSHI" sh.p.k
2. Shtimi i kapitalit te shoqerise "PALUSHI" sh.p.k ne nga 100.000 leke ne shumen prej 20.200.000 leke
3. Depozitimimin e ketij vendimi prane Zyres se Rregjistrimit Tregtar.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARSYE:**

Ne baze te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Rregjistrimin Tregtar"

**VENDOSA:**

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitimin e vendimit te Nr.6 date 03.07.2006 te Ortakut te vetem te shoqerise "PALUSHI" sh.p.k. ne te cilen eshte vendosur:
  1. Miratimin e raportit te ekspertimit ne lidhje me shtesen e kapitalit te shoqerise "PALUSHI" sh.p.k
  2. Shtimi i kapitalit te shoqerise "PALUSHI" sh.p.k ne nga 100.000 leke ne shumen prej 20.200.000 leke
  3. Depozitimin e ketij vendimi prane Zyres se Rregjistrimit Tregtar.
- Te behen ndryshimet perkatese ne Zyren e Rregjistrimit Tregtar ne kollonat respektive duke vijezimet me vije te kuqe.  
Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

**GJYQTARE**

**Arjana GUNBARDHI (CACO)**



Urdhevi Registrirung

1-

a- Th. y. l. A. P. LUMAI th. y. l.  
me seli ni Kulei L i d. l. 5 q. 5


b- Kapitoli 100.000 l. l.

c- Koli z p. j. o. mbi 20 v. j. t.

a- Me artikël të shprehur  
Marrimor Polu shi dhe Qamit Ademoj

b- Objekt  
Dokumentari me fusha e ndalimit pruzhatisur  
dhe zbotim  
Inye dhe p. j. o. debites dit. t. p. t. sh.

Statuti	5 fl. l.	
Atlet i thar. l.	2 fl. l.	
Dato e vendimit		14. 3. 98
" regjistruar		16. 3. 98

Cyrtor  
Ande Logo.  


**KONTRATE**  
**PER THEMELIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"A.P. LUMA-1" SH.P.K. KUKES**



Personat që firmosin më poshtë :  
**Meriman PALUSHI** i biri i Ahmetit, i datëlindjes 1959, lindur dhe banues në Kukës, L.5, shk.5 ap.5, i identifikuar me pasaportën EV 039806  
**Qamil ADEMAJ** i biri i Milaimit, i datëlindjes 1953, lindur dhe banues në Kukës, i identifikuar me letërnjoftimin Nr EV 025887,

Kanë hartuar si më poshtë vijon **Kontratën e Themelimit** të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar .

**Neni 1**

Personat fizikë të sipërpërmendur , me vullnetin e tyre të lirë dhe në pajtim me legjislacionin shqiptar në fuqi, kanë dakort të krijojnë shoqërinë e përbashkët me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin

**"A.P. LUMA-1" SH.P.K. KUKES**

Selia e shoqërisë ndodhet **Kukës me adresë L.5 shk.5 ap.5.**

Ortakët e shoqërisë do të jenë **z.Meriman PALUSHI & z.Qamil ADEMAJ.**

Administratori i shoqërisë do të jetë **z.Meriman PALUSHI**

Drejtuues teknik i shoqërisë do të jetë **z.Qamil ADEMAJ.**

Shoqëria ka të drejtë **të krijojë filialet e saj brënda dhe jashtë vendit në çdo kohë** që të çmohet e arësyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

**Neni 2**

Shoqëria **"A.P. LUMA-1" SH.P.K. KUKES** gëzon statusin e personit juridik . Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj **kontrate , statutit** të saj dhe **legjislacionit** shqiptar në fuqi. Statuti i shoqërisë i bashkangjitet kësaj kontrate dhe është pjesë përbërse e saj .

**Neni 3**

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe **mbi 20 vjet.**

Shoqëria e mbaron aktivitetin e saj me kalimin e afatit të parashikuar në këtë kontratë, në qoftë se ortakët me vullnetin e tyre të lirë nuk e zgjasin këtë afat .

Shoqëria e mbyll aktivitetin e saj edhe para afatit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, në qoftë se për këtë marrin vendim unanim të gjithë ortakët që bëjnë pjesë në këtë shoqëri .

**Neni 4**

Shoqëria do të ketë objekt të veprimtarisë së saj :

**\* veprimtarine ne fushen e ndertimit**

**Per zbatim : ( sipas licenses perkatese te Drejtuesit Teknik z. Qamil Milaim Ademi Z.2067 nr.866 date 07.08.1997)**

**Kat 1 Punime dheu, sistemime taracime terrenesh , etj**

Kat 3 Ndertime civile dhe ekonomike.

Kat 4/a Nderim rruge kat. V, IV

Kat 6/a Nderim vepra arti te vogla deri 6m

Kat 8/b ndertim ujsjellsash e kanalizime

c ndertim vepra kullimi, ujitje toke e impiante vaditese.

Kat10/a rikonstruksion godinash civile e ekonomike, veshje fasadash, etj

Per projektim : ( sipas licenses perkatese te Drejtuesit Teknik z. Qamil Milaim Ademi  
A.0142 nr.866 date 07.08.1997)

Kat 1/ c plane regulluese fshattrash e qendrash te banuara.

/d studime pjesore urbanistike

/e plan vendosje objektesh te veçanta

Kat 2/a projektme ndertimesh civile, ushqimore, industriale, materiale ndertimi turistike,  
bujqesore, etj. deri dy kate.

/b projektme ndertimesh civile, ushqimore, industriale, materiale ndertimi turistike,  
bujqesore, etj. mbi dy kate.

Import eksport te prodhimeve me konsruksione metalike, b/arme, plastike, druri dhe  
kombinime te ndryshme.

tregtim me shumice dhe pakice te blloqeve te betonit dhe materialeve te ndertimit si dhe  
prodhim dhe transportim te tyre.

Bar - Restorant.

tregtim te artikujve te ndryshem te konsumit te gjere, ushqimore, industriale, materiale  
ndertimi elektroshtepiake, hidrosanitar, shkollor, lende te pare per to me shumice dhe pakice  
import eksport te tyre.

Si dhe cdo veprimtari tjetër qe vecas ose se bashku me ato te permendura me siper do te  
konsiderohen si te pershtatshme dhe me leverdi per rritjen dhe zhvillimin e shoqerise.

#### Neni 5

Kapitali themeltar i kësaj shoqërie do të jetë 100.000 (njëqindmijë)lekë. Të gjitha pjesët e kapitalit  
themeltar janë nënshkruar e shlyer plotësisht dhe janë shpërndar ndërmjet ortakëve si më poshtë:

- |                    |                              |         |
|--------------------|------------------------------|---------|
| 1. Meriman PALUSHI | 50.000 lekë (pesëdhjet mijë) | ose 50% |
| 2. Qamil ADEMAJ    | 50.000 lekë (pesëdhjet mijë) | ose 50% |

#### Neni 6

Fitimet neto që do të realizohen nga veprimtaria e kësaj shoqërie do të ndahen ndërmjet ortakëve në  
proporcion me kontributin e tyre në kapitalin themeltar

#### Neni 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj të tretëve gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie, kjo shoqëri do t'i  
përgjigjet vetëm me kapitalin e saj

Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi për detyrimet e shoqërisë me pasuritë e tyre që nuk bëjnë pjesë në  
kapitalin e kësaj shoqërie.

#### Neni 8

Nuk mund të pranohet në shoqëri si ortak një person i tretë pa pëlqimin unanimit të ortakëve.

Nuk mund të hiqet dorë nga kjo kontratë në menyrë të një anëshme pa pëlqimin e ortakëve të tjerë.

Ortaku që dëshiron të shesë pjesën e tij në këtë shoqëri është i detyruar që ofertën e tij për shitje t'ia bëjë ortakëve të tjerë dhe në qoftë se këta të fundit nuk pranojnë blerjen ose nuk japin përgjigje brenda 30 ditëve nga dita e berjes së ofertës, atëherë ortaku është i lirë të disponojë pjesën e tij.

#### Neni 9

Ortakët janë të detyruar të ruajnë karakterin konfidencial të aktivitetit të shoqërisë.

Ortaku që shkel detyrimin e më sipërm dhe nga kjo shkelje i shkaktohet dëm shoqërisë, është i detyruar të shpërblej dëmin.

#### Neni 10

Marrëdhëniet e punës në shoqëri ose në filialet e saj rregullohen nëpërmjet *kontratës kolektive të punës*.

#### Neni 11

Konfliktet që lindin ndërmjet ortakëve duhet të zgjidhen *në marrëveshje* midis tyre. Në qoftë se ortakët nuk merren vesh për zgjidhjen e konflikteve me mirëkuptim *organ kompetent* për zgjidhjen e tyre është *Gjykata e Rrethit Kukës*.

#### Neni 12

Dispozita të hollësishme për organizimin e shoqërisë përcaktohen *në Statutin* e saj.  
*Ortakët pasi lexuan me vëmendje kontratën e mësipërme dhe e gjetën konform vullnetit të tyre e nënshkruan rregullisht.*

### ORTAKET

z. Meriman PALUSHI



z. Qamil ADEMAJ







# STATUTI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### "A.P. LUMA-1" SH.P.K. KUKES

#### KREU I

#### FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

##### Neni 1

##### FORMA

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "A.P. LUMA-1" SH.P.K. KUKES, me poshte e quajtur shoqeri, formohet nga ortaket themelues:

Meriman PALUSHI i biri i Ahmetit, i datelindjes 1959, lindur dhe banues ne Kukes, L.5,shk.5 ap.5,i identifikuar me pasaporten EV 039806  
Qamil ADEMAJ i biri i Milaimit, i datelindjes 1953, lindur dhe banues ne Kukes, i idenmtifikuar me leternjoftimin Nr EV 025887,

Shoqeria krijohet ne perputhje me ligjin Nr 7637 date 4.11.1992 dhe ligjin Nr 7638 date 19.11.1993 dhe njihet si person juridik pasi regjistroheshet ne Gjykatën e rrethit Tirane.

##### Neni 2

##### EMERTIMI I SHOQERISE

Emërtimi i shoqërisë është "A.P. LUMA-1" SH.P.K. KUKES

##### Neni 3

##### SELIA E SHOQERISE

Selia qendrore e shoqerise do te jete *ne Kukes me adrese L.5 shk.5 ap.5.*

Me vendim te asamblese se ortakeve mund te hape dege, zyra, filiale ose perfaqesi te Shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte saj.

##### Neni 4

##### KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete kohezgjatje mbi 20 vjet, si date fillestare do te merret data e regjistrimit te saj ne Gjykatën e rrethit *Tirane.*

##### Neni 5

##### OBJEKTI I SHOQERISE

Objekt i veprimtarise se shoqerise "A.P. LUMA-1" SH.P.K. KUKES eshte si vijon:

\* *veprimtarine ne fushen e ndertimit*

Per zbatim : ( sipas licenses perkatese te Drejtuesit Teknik z. Qamil Milaim Ademi  
Z.2067 nr.866 date 07.08.1997)

Kat 1 *Punime dheu, sistemime, tarracime taracime terrenesh, etj*

Kat 3 *Ndertime civile dhe ekonomike.*

*Kat 4/a Ndertim rruge kat. V, IV*

*Kat 6/a Ndertim vepra arti te vogla deri 6m*

*Kat 8/b ndertim ujsjellsash e kanalizime*

*c ndertim vepra kullimi, ujitje toke e impiante vaditese.*

*Kat10/a rikonstruksion godinash civile e ekonomike, veshje fasadash, etj*

*Per projektim : ( sipas licenses perkatese te Drejtuesit Teknik z. Qamil Milaim Ademi  
A.0142 nr.866 date 07.08.1997)*

*Kat 1/ c plane regulluese fshatrash e qendrash te banuara.*

*/d studime pjesore urbanistike*

*/e plan vendosje objektesh te veçanta*

*Kat 2/a projektme ndertimesh civile, ushqimore, industriale, materiale ndertimi turistike,  
bujqesore, etj. deri dy kate.*

*/b projektme ndertimesh civile, ushqimore, industriale, materiale ndertimi turistike,  
bujqesore, etj. mbi dy kate.*

*Import eksport te prodhimeve me konsruksione metalike, b/arme, plastike, druri dhe  
kombinime te ndryshme.*

*tregtim me shumice dhe pakice te blloqeve te betonit dhe materialeve te ndertimit si dhe  
prodhim dhe transportim te tyre.*

*Bar - Restorant.*

*tregtim te artikujve te ndryshem te konsumit te gjere, ushqimore, industriale, materiale  
ndertimi elektroshtepiake, hidrosanitar, shkollor, lende te pare per to me shumice dhe pakice  
import eksport te tyre.*

*Si dhe cdo veprimtari tjeter qe vecas ose se bashku me ato te permendura me siper do te  
konsiderohen si te pershtatshme dhe me leverdi per rritjen dhe zhvillimin e shoqerise.*

## KREU II

### KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR DHE TRANSFERIMI

#### Neni 6

#### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar iu shoqerise eshte 100.000 leke e cila eshte likujduar prej ortakeve themelues ne masen 50% secili ortak.

#### Neni 7

#### KONTRIBUTET E KAPITALIT

Kapitali i percaktuar ne nenin 6 te ketij statuti do te quhet "Kontributi" kapitali i ortakeve themelues si vijon : Meriman Palushi dhe Qamil Ademaj zoterojne secili perkatesisht 50% te kuotave te kapitalit themeltar. Asambleja e ortakeve ka te drejte ti beje shtese kapitalit te shoqerise.

#### Neni 8

#### NDARJA E FITIMIT

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqerise i takon ne masen 50% secilit ortak.



Neni 9

LINJA E TRANSFERIMIT TE PJESEVE TE KAPITALIT

Kapitali themeltar eshte lirisht i transferueshem tek personat e trete ne qofte se vendos asambleja e ortakeve per kete qellim. Gjithashtu ato jane lirisht te transferueshme ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ne rruge trashegimie. Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt noterial.

KREU III

STRUKTURA JURIDIKE, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 10

ORGANET E SHOQERISE

Organet e shoqerise jane:

Asambleja e ortakeve e cila perbehet prej ortakeve themelues.

Administratori i cili do te jete ortaku i shoqerise *z. Meriman Palushi*

Eksperti kontabel.

Neni 11

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Asambleja e ortakeve perbehet prej anetareve themelues. Ajo miraton raportin e administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore mbas mbylljes se vitit financiar. Keto dokumente si dhe raporti i ekspertit kontabel u komunikohen ortakeve dhe vihen ne dispozicion te tyre ne seline e shoqerise 15 dite perpara dates se mbledhjes se asamblese.

Gjithashtu asambleja merr vendim per ndryshimin e statutit, zmadhimin e kapitalit me ane te kontributeve ne natyre dhe me ane te kontributeve ne para, zvogelimin e kapitalit, emerone ekspertin kontabel, shenderrimin e shoqerise ne nje forme tjeter, punesimin e punonjesve dhe pagat konform legjislacionit ne fuqi. Ortaket mund ti delegojne kopetencat e tyre.

Vendimet e asamblese merren pas konsultimit me shkrim te ortakeve me shumice votash. Ne rast se votat jane te barabarta, vota e administratorit eshte percaktuese ne marrjen e vendimeve. Ortaket lajmehohen me leter rekomande te pakten 15 dite perpara mbledhjes se asamblese. Ne kete leter njoftohet rendi i dites. Lajmerimi behet nga administratori ose ne mungese te tij nga eksperti kontabel i autorizuar.

Çdo ortak mund te kerkoje ligjerisht caktimin e nje mandatmbajtessi te ngaruar per thirrjen e asamblese dhe caktimin e rendit te dites.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblesë vet ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij dhe disponon një numër votash të barabart me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron .

Secili ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje person tjeter ne rast se nuk merr pjese vete ne mbledhje.

Ne mbledhjet e asamblese ose ne konsultimet me shkrim vendimet merren nga ortaket.

Ne rast se ortaku nuk bie dakort , atehere konsultohen per here te dyte, ne qofte se edhe per here te dyte nuk bien dakort per marrjen e vendimeve atehere vota e administratorit ortak( ose administratorit jo ortak) eshte primare.



Neni 12  
FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKEVE

Fusha e autoritetit te ortakeve dhe perqindja e fitimeve ose humbjet do te kene si kriter baze kapitalin e shoqerise, si dhe kopetencat qe gezon ne marrjen e vendimeve te cdo karakteri te percaktuara ne kete statut.

Neni 13

Ne gjitha aktet dhe dokumentat qe nxirren nga shoqeria dhe te destinuara per te tretet, si dhe letrat, faturat, lajmerimet dhe publikimet e tjera duhet te tregojne lexueshem emrin e shoqerise dhe mepas fjalet " Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" ose inicialet sh.p.k. dhe emrin e administratorit.

Neni 14  
ADMINISTRIMI

Shoqeria administrohet nga administratori ortak *z. Meriman Palushi*

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit me interes te shoqerise dhe nenshkrimin ne emer te shoqerise te te gjitha akteve ne mardhenie me te tretet.

Administratori ka te gjitha kopetencat perjashtuar kopetencat e asamblese te cilat jane percaktuar shprehimisht ne kete statut dhe ne ligj.

Ne rast se zgjerohet aktiviteti i shoqerise si dhe ne rast se ortaku qe kryen funksionin e administratorit nuk deshiron te kryeje kete funksion, merret vendim per emerimin e nje ose me shume administratoreve te tjere. Ne kete rast emerimi do te behet me nje afat prej tre vjetesh financiare, me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose te shkarkimit te perkoheshem.

Ne rast te emerimit te administratorit jo ortak, ai ne mardheniet me ortaket dhe te tretet, ka te gjitha kopetencat per te kryer te gjitha veprimet e administrimit te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet veprimeve qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise, me perjashtim te atyre kopetencave qe ligji dhe statuti ia japin shprehimisht asamblese se ortakeve.

Administratori eshte pergjegjes ndaj shoqerise dhe te treteve per shkelje ligjore, qofte per shkelje te statutit, ose faje te kryera gjate administrimit te tij.

Neni 15  
EKSPERTI KONTABEL

Ortaket mund te emerojne nje apo disa eksperte kontabel te autorizuar. Kopetencat, funksionet, detyrimet, pergjegjesite, zevendesueshmeria, terheqja, shkarkimi dhe shperblimi i ekspertit ose eksperteve te autorizuar, percaktohen ne baze te ligjit Nr 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"

Neni 16  
KONFIDENCIALITETI

Asambleja e ortakeve, administratori si dhe persona te tjere te pranuar ne shoqeri bien dakort qe te mos ti ekspozojne asnje personi te jashtem informacionet qe do te disponoje shoqeria, kontratat qe ajo do te lidhe si dhe planet dhe qellimet e saj per te ardhmen.

Neni 17  
ORGANI SINDIKAL

Ky organizem do te organizohet dhe do te funksionojë ne baze te legjislacionit ne fuqi.

KREU IV  
LIBRAT E LLOGARISE, BILANCI, FITIMI, SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

Neni 18  
LIBRAT E SHOQERISE

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacionit kontabel qe kerkon legjislacioni ne fuqi edhe keto libra:

- 1-Libri i shoqerise ne te cilin shenohen emrat e plote te ortakeve, kapitali themeltar.
- 2-Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te asamblese se ortakeve
- 3-Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te organit sindikal.

Dy librat e pare mbeten nen kujdesin e asamblese se ortakeve kurse i treti nen kujdesin e organit sindikal.

Neni 19  
VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, EKSPERTET KONTABEL

Viti i parë financiar fillon *nga data e regjistrimit* të shoqërisë dhe *mbaron më 31 dhjetor 1998*.

Çdo vit tjetër financiar *fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor*.

Llogaritë vjetore , inventari , raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga Administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar , *miratohen nga Asambleja*.

Miratimi i bilancit vjetor bëhet *brënda 31 marsit të vitit pasardhës* .

Veprimtaria e ekspertit ose e eksperteve kontabel te autorizuar nga asambleja e ortakeve do te funksionojë sipas nenit 69 te ligjit 7638 date 19.11.1992.

Neni 20  
ZGJATJA E AFATIT

Zgjatja e afatit te shoqerise qe eshte percaktuar ne kete statut mund te vendoset nga asambleja e ortakeve.

Neni 21  
AKTIVITETI FINANCIAR

Ne cdo mbyllje te cdo viti financiar behet inventari dhe llogaria vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin si dhe hartohet nje raport me shkrim.

Bilancit i bashkangjiten:

- a-nje situacion mbi garancite e dhene nga shoqeria.
- b-nje situacion mbi sigurimet e bera nga shoqeria

Raporti perfshin gjendjen gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtarite e mundeshme qe jane zhvilluar nga data e mbylljes se viti financiar deri ne ditën qe eshte hartuar ky raport. Dokumentat vihen dispozicion te ekspertit ose te eksperteve te autorizuar dhe ne perfundim miratohen nga asambleja e ortakeve.

## Neni 22

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, Asambleja përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividendeve mbi fitimin. Fitimi që do të ndahet ndërmjet ortakëve në përpjestim me pjesët e kapitalit përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për **fondin rezervë të domosdoshëm** (5% e fitimit të çdo viti deri sa ky fond të arrijë vlerën e 1/10 së kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetër të jenë zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga viti i mëparshëm.

## Neni 23

### ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA, LIKUJDIMI I SHOQERISE ZGJATJA E AFATIT

Zgjatja e afatit të veprimtarisë së shoqërisë **vendoset nga Asambleja**

## Neni 24

Shoqëria mund të **prishet** me përfundimin e afatit të përcaktuar në këtë statut, me përjashtim të rasteve kur bëhet zgjatja e afatit ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

Shoqëria **nuk prishet** kur njëri prej ortakëve falimenton, bëhet i pa aftë ose vdes.

## Neni 25

Shoqëria **hyn në procesin e likuidimit** që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Asambleja **emëron** një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjëndjen e aktivitetit dhe pasivitetit të saj, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

Në fund të procesit të likuidimit Asambleja vendos mbi bilancin përfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likujduesit dhe mbi mbylljen e procesit të likuidimit

Mbas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar tek kontribuesit përkates, likujduesi ndan kapitalet e mbetura ndërmjet ortakëve proporcionalisht me pjesët e tyre në kapitalin themeltar.

## KREU IV DISPOZITAT E FUNDIT

## Neni 26

Shëndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në një formë tjetër të shoqërive tregtare kryhet me vendim të Asamblesë së ortakëve.

## Neni 27

Punësimi i punonjësve në shoqëri do të bëhet **mbi bazën e Kontratës Kolektive të Punës**. Në Kontratën Kolektive të Punës rregullohen këto çështje:

\* **kushtet dhe mënyra e marrëdhënjes së punës** ;

- \* fillimi i punës;
- \* koha e punës;
- \* mbrojtja në punë;
- \* të drejtat dhe detyrimet në punë;
- \* paga e punës, shpërblimi, etj.;
- \* pushimi i marredhënjes së punës.

#### Neni 28


Të gjitha *mosmarrëveshjet* që mund të lindin ndërmjet ortakëve ose ndërmjet shoqërisë dhe ortakëve gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit , do të zgjidhen *me mirkuptim* ndërmjet tyre dhe kur mirkuptimi nuk arrihet *organi kompetent* do të jetë Gjykata e Rrethit Kukës .

#### Neni 29

Ky Statut është hartuar në Kukës më, 17.02.1998 , në katër ekzemplarë origjinal duke patur fuqi të barabartë ligjore.

### ORTAKET

z. Meriman PALUSHI



z. Qamil ADEMI



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ZYRA E NOTERISE  
TIRANE

Nr. 1342.....Rep  
Nr. 151.....Kol

### V E R T E T I M


